



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2024 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – Sigurim Fizik
Kohëzgjatja e emërimit	6 mujor
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	400.00 Euro
Nr. i kërkuar	6
Data e njoftimit	18.10.2024
Afati për aplikim	25.10.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH “Tregu” -Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	18.10.2024 – OSH Sigurim Fizik

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve do të punojë në pozitë të Punonjësit të Sigurimit.
- Sigurimi obligohet të qëndroj në pikat hyrëse-dalëse të Tregut;
- Kryerja e patrullimeve të rregullta në ambientet e Ndërmarrjes për të siguruar që të gjitha zonat janë të sigurta dhe të mbrojtura;
- Kontrollimi i hyrjeve dhe daljeve , përfshirë verifikimin e identitetit të personave dhe kontrollin e aksesit në zona të kufizuara;
- Obligohet të ruaj dhe të mbrojë pasurinë e Tregut ;
- Reagimi dhe menaxhimi i incidenteve të sigurisë si vjedhje, dëmtime, ose ngjarje të tjera emergjente;
- Kontaktimi dhe koordinimi me forcat e sigurisë, policinë, ose shërbimet e tjera të emergjencës kur është e nevojshme;
- Sigurimi që të gjitha politikat dhe procedurat e sigurisë janë të ndjekura dhe zbatuara nga stafi dhe vizitorët;
- Ndihma në zhvillimin dhe përditësimin e protokolleve dhe procedurave të sigurisë për të përmirësuar mbrojtjen e pronave;
- Dokumentimi i çdo incidenti të sigurisë dhe mbajtja e raporteve të detajuara për aktivitetet e sigurisë dhe ndodhitë e veçanta;
- Të informoj menjëherë mbi shkeljet apo veprat penale për të cilat ai merr djeni.
- Të raportoj çdo informatë të marrë e cila ka lidhje me kryerjen më parë ose për përgatitjen për të kryer një vepër penale.
- Të informoj menjëherë mbikëqyrësin nëse ndaj tij ka filluar ndonjë procedim penal.
- Të raportoj tek mbikëqyrësi çdo ankesë të marrë në lidhje me sjelljen e një punonjësi tjetër të Tregut.
- Të mos mungoj në shërbim/punë apo të largohet nga vendi i shërbimit pa lajmërimin e mbikëqyrësit.
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së



mbikëqyrësit të drejtpërdrejt .

• 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Shkolla fillore apo e mesme.

4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Vërtetimin nga Policia e Kosovës se ka/nuk ka dosje penale në sistemin informativ të Policisë së Kosovës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrit dhe të deklaruara në aplikacion.

6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 25.10.2024 në ora 16:00 në emalin punesimi@pak-ks.org apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidatëve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 31.10.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-